



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), si dhe nenit 7, paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 30, paragrafi 3 të ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.12.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Doc. No. 06
Dok. No. 06
Nr. Prot. 2245/23
Br. Prot. 2245/23
Data 19.12.2023
Dok. 19.12.2023

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin APK-DPKI-06-2050/23, për zyrtarin e lartë z. Izmir Zeqiri, pasi që i njëjti në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, ka emëruar vajzën e tij, Drejtoreshë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut, duke rënë ndesh me nenin 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 6 dhe nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.6 dhe 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon nga Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, anulimin e aktit të marrë në kushtet e konfliktit të interesit dhe shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, procedon rastin në prokurorinë kompetente, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtit bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit për zyrtarin e lartë z. Izmir Zeqiri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informacioneve publike se zyrtari i lartë, z. Izmir Zeqiri, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, ka emëruar vajzën e tij, DH.Z., Drejtoreshë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-01/2109/23, duke e njoftuar palën për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit dhe njëkohësisht i ka kërkuar dokumentacion relevant lidhur me rastin në procedurë.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, është realizuar një takim me z. Izmir Zeqiri në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë diskutuar dhe shtjelluar gjerësisht të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërsa z. Izmir Zeqiri ka paraqitur arsyet e tij lidhur me emërimin e vajzës së tij në pozitën e lartcekur si dhe të njëjtat arsye i ka deponuar edhe në formë të shkruar.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i deponuar nga z. Izmir Zeqiri në takimin e mbajtur në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Me Vendimin Nr. 01/09, datë: 25.05.2023, Kryetari i Zubin Potokut z. Izmir Zeqiri, ka emëruar Dh. Z., Drejtoreshë të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut;

Shkresa zyrtare e deponuar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nga Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, z. Izmir Zeqiri, Nr. Prot.: 177, dt.: 04.12.2023 (e pranuar nga APK sipas Protokollit Nr.: DPKI-06/01/2109-1/23, dt. 05.12.2023), përmban informacionin vijues, citojmë nga shkresa:

"Vendimin për emërimin e Drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut;

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58, pika (f), nenit 62, paragrafi 62.2 dhe nenit 66, paragrafi 66.1, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta e Republikës së Kosovës/Nr.28/04 qershor 20008); si dhe neni 31, pika (f), të statutit të Komunës së Zubin Potokut me numër 0202-750/I, të datës 19.05.2023;

Për informimin tuaj rreth informacionit shtesë ose dokumentacionin në lidhje me emërimin e Drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut;

Emërimi i Drejtoreshës së Drejtorisë erdhi si rezultat i mosgatishmërisë dhe frikësimit të komunitetit serb për tu përfshirë në kabinetin e kryetarit pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Zubin Potok të mbajtura me 23 prill 2023 (vendim nr.01/571-2023, të datës 28.04.2023);

Bashkangjitur gjeni bisedën e zhvilluar në lidhje me ofertën e tetë (8) Drejtorive për komunitetin Serb (përfshirë edhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, pasi janë shumicë në Komunë), ku kanë refuzuar marrjen e pozitive pasi që janë të frikësuar të gjithë përfshirë kundërshtarët e Vuçiqit dhe kjo sipas tyre është e pabesueshme;

Emërimi i Drejtoreshës së Drejtorisë erdhi edhe si pasojë e mosgatishmërisë së Komunitetit Shqiptar për tu përfshirë në kabinetin e Kryetarit, ku kemi ofruar bashkëpunim për të gjitha partitë politike shqiptare;

Emërimi i Drejtoreshës së Drejtorisë erdhi si pasojë e respektimit të barazisë gjinore (Ligji Nr.05/L-020 për barazi gjinore);

Në mungesë të interesimit të të gjitha palëve, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe rrezikut për të pramuar detyrën, jemi detyruar të plotësojmë kabinetin edhe me familjar të afërm.

Meqë Komuna për momentin nuk ka kapacitete të mjaftueshme, siç e dimë të gjithë dhe jemi të vetëdijshëm të gjithë, emërimi i Drejtoreshës së Drejtorisë ka të bëjë me shumë më sakrificë se sa me përfitime personale, vet veriu i Republikës së Kosovës është gjendje e jashtëzakonshme, por me gjithë sfidat që po ballafaqohemi si komunë dhe me ato kapacitete që i kemi, jemi duke punuar për t'i ngritë kapacitetet tona si komunë që gjendja të kthehet në normalitet".

Në takimin e mbajtur në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Izmir Zeqiri, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, konfirmon se për arsyet e lartcekura, ka emëruar vajzën e tij Drejtoreshë të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut, por megjithatë, i njëjti deklaron se është i hapur maksimalisht për bashkëpunim dhe zbatim të vendimeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion, përfshirë arsyet (specifikat) e deponuara edhe me shkrim nga pala në takimin e mbajtur në Agjenci, dhe më pas ka konstatuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi se, ekziston konflikti i interesit në rastin konkret, për zyrtarin e lartë z. Izmir Zeqiri, pasi që i njëjti në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, ka emëruar vajzën e tij, Drejtoreshë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Zubin Potokut, duke rënë ndesh me nenin 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 6, nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.6 dhe 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje".

...lidhur me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."

nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

nën-paragrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]",

si dhe nën-paragrafin 1.12 të këtij neni, i cili definon nocionin e vendimmarrjes si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik".

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e *vendimmarrjes*, nën kushtet e ekzistencës së *interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm të tij* në një çështje të caktuar. Në rastin konkret, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar konfliktin e interesit, pasi që janë plotësuar kushtet e sipërpërmendura kumulative, si: *përfshirja në vendimmarrje dhe ekzistenca e interesit privat të personave të afërm të zyrtarit*.

Prandaj, duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar më sipër, si dhe në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon nga Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, anulimin e aktit të marrë në kushtet e konfliktit të interesit dhe shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit, konform nenit 24, paragrafi 6, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"Agjencia inicijon procedurën administrative dhe/ose gjyqësore për anulimin e akteve dhe për obligimin e zyrtarit përgjegjës për shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit.

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, procedon rastin në prokurorinë kompetente, në pajtim me nenin 24, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit sipas legjislacionit në fuqi", si dhe

"Agjencia, çdo zyrtar, udhëheqës i zyrtarit dhe çdo institucion ushtrojnë kallëzim penal në prokurorinë e shtetit kompetente ndaj zyrtarit i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës",

...lidhur me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit ku përcaktohet se:

Agjencia është përgjegjëse për:

"Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent".

IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 24, paragrafi 12, dhe 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"[...] Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë", si dhe

“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative”.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore e Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

